

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: "Sistemi Multifunksional për sallën e Këshillit Bashkiak".

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Pajisje audio-vizuale 32321200-1, Altoparlantë 32342000-2, Mikrofonë dhe komplete folëse 32342300-5, Pajisje akustike 32342400-6, Amplifikues 32343000-9, Ekrane 32351200-01.

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 14,623,360 (katërmbëdhjetë milion e gjashtëqind e njëzet e tre mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH,

Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankes së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në 155,929 (njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e njëzet e nëntë) Euro

*** Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 08/07/2026 është 93.78 Lek/Euro.**

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë me anë të VKB-së Nr. 100 dt 18.12.2025 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2026" (i ndryshuar).

Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër ose afati i zbatimit të kontratës: Periudha e zbatimit të kontratës do të jetë 2 (dy) muaj kalendarik. Periudha e mirëmbajtjes do të jetë 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e marrjes në dorëzim. Në total afati i zbatimit të kontratës do të jetë 14 (katërmbëdhjetë) muaj kalendarik.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT PËR:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

c. Formularin e Ofertës Ekonomike, sipas Shtojcës 1

d. Lista e çmimeve të artikujve sipas Shtojcës 3

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9. (për secilin lot)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 8 të DST-së.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Neni 43, pika 4, të VKM nr. 285 “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy balance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2. Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së

kërkuar duhet të jetë në një vlerë **jo më të vogël se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet**. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit/ vlera e pritshme e kontratës së përlllogaritur për lot, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c dhe pika 5, si dhe neni 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

Pika 2/a: dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;”. Vlera e përlllogaritur është mbi kufirin e lartë monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43, pika 5, “Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

2.2.3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2026 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas adresave të regjistruar sipas QKB. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar) si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar).

Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen

vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatorët ekonomik duhet të paraqesin dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40/4, si dhe neni 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën. Bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, citohet: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të zotërojë liçencë profesionale të shoqërisë, e vlefshme, për realizimin e objektit të kontratës, të lëshuar nga MPPT/MTI ose nga institucionet e autorizuar me ligj, me kategoritë e mëposhtme:

- NS 13 A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni

- NS-14 A Impiante të brendshme elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e liçensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në Republikën e Shqipërisë. (Mbështetur në Rregulloren për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në nr.42, datë 16.01.2008).

Në rastet e mbështetjes në kapacitete të subjekteve të tjera / Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili anëtar i bashkimit duhet t'i disponojë në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim / kontratën e bashkëpunimit.

Argumentimi: Kërkesa për disponimin e liçensave profesionale NS-13 A – Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni dhe NS-14 A – Impiante të brendshme elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV etj., është vendosur në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik të ndryshuar, si dhe pika 5 e nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, sipas të cilave autoriteti kontraktor mund të kërkojë liçenca profesionale dhe kapacitete teknike të nevojshme për realizimin e objektit të kontratës.

... 5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) liçencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe liçencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

...“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”

Objekti i kësaj procedure nuk konsiston vetëm në furnizimin e pajisjeve, por përfshin gjithashtu instalimin fizik, konfigurimin, integrimin dhe vënien në punë të sistemit multifunksional të Sallës së Këshillit Bashkiak, duke përfshirë sistemin e diskutimit, sistemin audio, kamerat PTZ, njësinë e regjistrimit, monitorin, softuerin e administrimit dhe votimit, si dhe të gjithë kabllimin dhe infrastrukturën mbështetëse të nevojshme për funksionimin e sistemit.

Licenca NS-13 A – Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni lidhet drejtpërdrejt me realizimin e rrjeteve të komunikimit dhe telekomunikacionit që do të përdoren për funksionimin e sistemit të diskutimit, komunikimin ndërmjet njërive delegate/chairman, komunikimin e kamerave PTZ, transmetimin e të dhënave të sistemit të votimit, si dhe integrimin e të gjithë komponentëve në një infrastrukturë të vetme komunikimi. Referuar specifikimeve teknike, sistemi mbështetet në rrjet komunikimi përmes kabllave dhe komunikim digjital ndërmjet pajisjeve, çka përbën veprimtari tipike të kategorisë NS-13.

Licenca NS-14 A – Impiante të brendshme elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV etj. lidhet drejtpërdrejt me instalimin e pajisjeve audio-video dhe elektrike të parashikuara në kontratë, si monitorët, kamerat PTZ, altoparlantët, amplifikatorët, DSP, njësitë e sekuencimit, pajisjet e regjistrimit etj. Zbatimi i kontratës kërkon ndërhyrje në infrastrukturën e brendshme elektrike dhe të komunikimit të godinës, realizimin e lidhjeve elektrike dhe të sinjalit, si dhe integrimin e tyre në një sistem të vetëm funksional.

Klasifikimi A është përcaktuar në përputhje me natyrën dhe vlerën e kontratës. Kërkesa për kriterin e sipërcituar synon të garantojë që operatori ekonomik disponon kapacitetin profesional dhe teknik minimal të nevojshëm për realizimin e sigurt dhe cilësor të punimeve të instalimit, integritetit dhe vënies në punë të sistemit multifunksional objekt kontrate.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 3 (tre) punonjës të diplomuar në degët informatikë/Teknologji Informacionit/ Elektronikë ose ekuivalente që do të angazhohen

në zbatimin e kontratës.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

Diplomë përkatëse për specialistët e kërkuar;

Kontratë pune të vlefshme

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas Shtojcës nr 9**. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa për staf është hartuar në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 40, pika 5 (i ndryshuar).

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

...”

Objekti i kësaj kontrate përfshin furnizimin, instalimin, konfigurimin, integrimin, testimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi multifunksional për Sallën e Këshillit Bashkiak, i cili përbëhet nga sisteme diskutimi dhe votimi elektronik, softuer administrimi, kamera PTZ me funksionalitete auto-tracking, sistem regjistrimi audio-video, monitorë, pajisje audio profesionale, rrjete komunikimi dhe infrastrukturë kabllimi.

Realizimi i këtyre aktiviteteve kërkon njohuri nga staf të diplomuar në fushat e teknologjisë së informacionit/elektronikës ose ekuivalente, konfigurimit të sistemeve audio-video, rrjeteve të komunikimit, integritit të pajisjeve hardware dhe software, si dhe testimit të funksionaliteteve të sistemit pas instalimit.

Numri minimal prej 3 (tre) specialistësh është përcaktuar duke marrë në konsideratë fazat e implementimit të kontratës, të cilat përfshijnë:

- analizimin e kërkesave dhe projektimin teknik;
- instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve;
- integrimin e sistemeve hardware dhe software;
- testimin funksional dhe akustik;
- trajnimin e përdoruesve;
- ofrimin e mirëmbajtjes dhe suportit teknik gjatë periudhës së kontratës.

Kërkesa të paktën 3 (tre) staf teknik të diplomuar në degët informatikë/Teknologji Informacionit/Elektronikë ose ekuivalente që do të angazhohen në zbatimin e kontratës është në propocion me

natyrën, kompleksitetin dhe vlerën e kontratës, si dhe i shërben autoritetit për të garantuar realizimin e shërbimeve të instalimit, konfigurimit, integritit dhe mirëmbajtjes së sistemit objekt prokurimi. Prania e këtyre specialistëve i jep garanci Autoritetit Kontraktor se operatori ekonomik disponon burimet profesionale dhe teknike të nevojshme për zbatimin me sukses të kontratës.

2.3.4. Për të garantuar implementimin me sukses të kontratës si dhe për të garantuar suportin përgjatë periudhës së parashikuar të mirëmbajtjes sipas dokumentit të termave të referencës dhe specifikimeve teknike, operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 8 (tetë) punonjës, që do të angazhohen në implementimin e kontratës, me kërkesat minimale si më poshtë:

Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti.

Të paktën 1 (një) Inxhinier Elektrik

Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për ITIL Foundation ose ekuivalente;

Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për Sigurinë e Rrjeteve në nivelin Profesional;

Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi në nivelin ekspert për zgjidhjen e ofertuar ose ekuivalente.

Të paktën 1 (një) punonjës ose teknik të fushës, të pajisur me kartela të sigurimit teknik nga I.SH.T.I. ose nga institucione ekuivalente me të.

Një punonjës mund të ketë edhe më shumë se një certifikim sipas kërkesave më sipër.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Certifikata/ Diplomë/Transkriptet përkatëse për specialistët e kërkuar;
- Kontratë pune të vlefshme
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik (emër mbiemër) profilin e punonjësve (certifikimet përkatëse) nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B;
- Listëpagesat sipas formularit eSig25 për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B.

Shënim: Kriteri i mësipërm do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa për staf është hartuar në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 40, pika 5 (i ndryshuar).

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

“

- a) *licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) *fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

- d) ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

...”

- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti.

Kërkesa për të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si Menaxher Projekti, duke qenë se objekti i kontratës përfshin një sërë aktivitete të ndërlidhura teknike dhe organizative, është e domosdoshme për të garantuar realizimin e një sërë shërbimesh të kërkuara të cilat duhet të planifikohen, koordinohen, monitorohen dhe kontrollohen në mënyrë të strukturuar përgjatë gjithë ciklit të implementimit dhe mirëmbajtjes së sistemit.

Gjithashtu, në dokumentin e termat e referencës dhe specifikimeve teknike, pjesë e dokumenteve standarde të tenderit, kërkohet ngritja e grupeve të punës, planifikimi i burimeve njerëzore dhe materiale, përcaktimin e hapave të realizimit të projektit, dokumentimin e kërkesave, testimin e sistemit, raportimin periodik dhe dorëzimin final të sistemit. Të gjitha këto aktivitete përbëjnë procese tipike të menaxhimit të projektit dhe është e domosdoshme prania e një punonjësi të certifikuar si menaxher projekti për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

Prania e një menaxheri projekti të certifikuar i jep Autoritetit Kontraktor garanci se operatori ekonomik disponon kapacitetin organizativ dhe metodologjinë e nevojshme për:

- administrimin efektiv të afateve të implementimit;
- identifikimin dhe menaxhimin e risqeve teknike dhe organizative;
- koordinimin e aktiviteteve të instalimit, konfigurimit dhe testimit;
- monitorimin e cilësisë së punimeve dhe shërbimeve;
- sigurimin e komunikimit të vazhdueshëm me Autoritetin Kontraktor;
- respektimin e afateve kontraktore dhe rezultateve të kërkuara.

Për sa më sipër, kërkesa për të paktën një Menaxher Projekti të certifikuar ëtë e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit, proporcionale me kompleksitetin teknik të kontratës dhe e nevojshme për garantimin e realizimit me sukses të projektit dhe të shërbimeve të mirëmbajtjes që do të ofrohen gjatë periudhës së kontratës.

- Të paktën 1 (një) Inxhinier Elektrik

Në dokumentin e termave të referencës dhe specifikimeve teknike pjesë e DST, Autoriteti ka kërkuar instalimin dhe integrimin e komponentëve të ndryshëm të sistemit, duke përfshirë sistemin e diskutimit dhe votimit elektronik, kamerat PTZ, njësinë e regjistrimit, monitorin, amplifikatorët, DSP, mikserin audio, altoparlantët, njësinë e sekuencimit të fuqisë, si dhe të gjithë kabllimin dhe lidhjet e nevojshme për funksionimin e plotë të sistemit.

Gjithashtu, operatori ekonomik ka detyrimin të sigurojë dhe instalojë të gjitha pajisjet, aksesoret, kabllimet, konektorët, elementët e montimit dhe komponentët ndihmës të nevojshëm për integrimin me infrastrukturën ekzistuese të institucionit.

Kërkesa për të paktën një Inxhinier Elektrik është veçanërisht e nevojshme duke marrë në konsideratë se sistemi përfshin amplifikatorë fuqie, DSP audio, monitor profesional 75”, sistem regjistrimi, kamera PTZ, njësi qendrore të diskutimit, altoparlantë dhe pajisje të tjera aktive që kërkojnë furnizim të qëndrueshëm elektrik dhe integrim të sigurt me infrastrukturën ekzistuese të

godinës.

Gjithashtu nëpërmjet kësaj kontrate, kërkohet kryerja e testimeve funksionale dhe akustike të sistemit pas instalimit, si dhe garantimin e funksionimit të qëndrueshëm të të gjithë komponentëve gjatë periudhës së mirëmbajtjes. Përmbushja e këtyre kërkesave kërkon njohuri të specializuara në fushën e instalimeve elektrike dhe sistemeve me tension të ulët.

Për sa më sipër, kërkesa për të paktën një Inxhinier Elektrik është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e shërbimeve dhe punimeve që do të realizohen në kuadër të kontratës, si dhe proporcionale me kompleksitetin teknik të sistemit objekt prokurimi.

- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për ITIL Foundation ose ekuivalente;

Plotësimi i kësaj kërkesë jep garanci më tepër që Operatori ekonomik garanton ideimin dhe konceptimin e shërbimeve IT të kontratës në mënyrë të menaxhueshme sipas standardeve ndërkombëtare të njohura, në gjithë ciklin e tyre, përfshirë këtu dhe shërbimet e mirëmbajtjes dhe termat e SLA-së.

Një certifikim për Information Technology Infrastructure Library (ITIL) ose ekuivalente është një set praktikash dhe kuadri rregullash dhe idesh për realizimin e shërbimit në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, që është pjesë e qëllimit të kontratës së Autoritetit Kontraktor.

- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për Sigurinë e Rrjeteve në nivelin Profesional; Prania për të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për Sigurinë e Rrjeteve në nivelin Profesional jep garanci se Operatori është i aftë të kryejë shërbime profesionale në këtë fushë. Specialistët e certifikuar për siguri në rrjetat garantojnë Autoritetin Kontraktor se stafi teknik i Operatorit Ekonomik është i certifikuar, ka njohuritë e duhura profesionale për realizimin e kontratës, për realizimin e shërbimeve specifike pjesë e termave të references, në të cilën përfshihet akses në ambjentet sensitive të AK dhe realizimi i lidhjeve dhe konfigurimeve të nevojshme për pajisjet e reja në Infrastrukturën e Autoritetit.

Referuar kërkesave të dokumentit të termave të referencës, sistemi, objekt kontrate përfshin njësi diskutimi dhe votimi elektronik, kamera PTZ, sistem regjistrimi audio-video, softuer administrimi dhe votimi, si dhe komponentë të tjerë që komunikojnë përmes rrjetit të komunikimit dhe integrohen me infrastrukturën ekzistuese të institucionit. Gjithashtu operatori ekonomik do të realizojë konfigurimin, testimin dhe mirëmbajtjen e sistemit gjatë gjithë periudhës kontraktore. Gjatë implementimit të kontratës do të kryhen konfigurime dhe ndërveprime me rrjetin e Autoritetit Kontraktor, konfigurime të komunikimit ndërmjet pajisjeve, konfigurime të sistemit të votimit, kamerave PTZ dhe komponentëve të regjistrimit, si dhe aktivitete mirëmbajtjeje që kërkojnë akses në infrastrukturën teknologjike të institucionit.

Këto aktivitete duhet të realizohen duke respektuar parimet e sigurisë së rrjeteve, me qëllim që implementimi i sistemit të mos krijojë dobësi sigurie, ndërprerje të shërbimeve apo ekspozim të paautorizuar të infrastrukturës ekzistuese.

Prania e një specialisti të certifikuar për Sigurinë e Rrjeteve garanton që implementimi i sistemit do të kryhet duke zbatuar praktikat profesionale për mbrojtjen e rrjetit, kontrollin e komunikimeve ndërmjet pajisjeve, identifikimin dhe minimizimin e risqeve të sigurisë, si dhe ruajtjen e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së sistemeve dhe të dhënave gjatë instalimit, konfigurimit, testimit dhe mirëmbajtjes së tyre.

- Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi në nivelin ekspert për zgjidhjen e ofertuar ose ekuivalente.

Kjo kontratë përfshin implementimin e një sistemi multifunksional të integruar, i përbërë nga sisteme diskutimi dhe votimi elektronik, kamera PTZ, sistem regjistrimi audio-video, sistem audio profesional, monitor, softuer administrimi dhe votimi, si dhe integrimin e të gjithë këtyre komponentëve në një platformë të vetme funksionale.

Referuar termave të referencës, operatori ekonomik ka detyrimin të realizojë analizën teknike, instalimin fizik të pajisjeve, konfigurimin e të gjithë komponentëve hardware dhe software, integrimin ndërmjet tyre, testimin funksional dhe akustik, trajnimin e stafit të Autoritetit Kontraktor, dorëzimin e dokumentacionit teknik, si dhe mirëmbajtjen e sistemit për një periudhë 12.(dymbëdhjetë).muajore.

Për realizimin e këtyre aktiviteteve është i nevojshëm dhe i domosdoshëm punonjës me njohuri të avancuara mbi pajisjet dhe zgjidhjen e ofertuar, pasi konfigurimi, integrimi dhe diagnostikimi i sistemit kërkojnë përdorimin e softuerëve të dedikuar, procedurave të konfigurimit dhe praktikave teknike të përcaktuara nga vetë prodhuesi. Certifikimi në nivel ekspert garanton që specialistët disponojnë njohuritë dhe kompetencat e nevojshme për implementimin korrekt të zgjidhjes së ofertuar, konfigurimin sipas rekomandimeve të prodhuesit, diagnostikimin e problematikave dhe rikthimin në funksionim të sistemit në rast incidentesh.

Numri minimal prej 2 (dy) specialistësh është përcaktuar duke marrë në konsideratë kompleksitetin e projektit dhe afatin prej vetëm 2 (dy) muajsh për implementimin e plotë të sistemit.

Gjatë kësaj periudhe duhet të zhvillohen paralelisht një sërë aktiviteteve teknike, si:

- instalimi fizik i pajisjeve;
- konfigurimi i sistemit të diskutimit dhe votimit;
- konfigurimi i kamerave PTZ dhe funksionaliteteve auto-tracking;
- konfigurimi i sistemit audio dhe regjistrimit;
- integrimi i të gjithë komponentëve;
- testimet funksionale dhe akustike;
- korrigjimi i problematikave të evidentuara gjatë testimeve;
- trajnimi i përdoruesve dhe dorëzimi i dokumentacionit teknik

Për shkak të afatit të kufizuar të implementimit, këto aktivitete nuk mund të realizohen në mënyrë efektive nga një specialist i vetëm ose nga një numër i pamjaftueshëm specialistësh, pasi do të krijoheshin vonesa në ekzekutimin e kontratës dhe do të rritej rreziku i mosrespektimit të afateve kontraktore. Prania e të paktën 2 specialistëve të certifikuar nga prodhuesi mundëson zhvillimin paralel të proceseve të instalimit, konfigurimit, integrimin dhe testimit, duke garantuar realizimin e kontratës brenda afatit të përcaktuar dhe sipas standardeve teknike të prodhuesit.

Gjithashtu, gjatë periudhës 12-mujore të mirëmbajtjes, disponimi i më shumë se një specialisti të certifikuar garanton vazhdimësinë e shërbimit, disponueshmërinë e ekspertizës teknike në rast incidentesh dhe eliminon varësinë nga një person i vetëm, duke siguruar mbështetje profesionale gjatë gjithë periudhës kontraktore.

- Të paktën 1 (një) punonjës ose teknik të fushës, të pajisur me kartela të sigurimit teknik nga I.SH.T.I. ose nga institucione ekuivalente me të.

Kërkesa për punonjës të pajisur me dëshmi të kualifikimit teknik është hartuar gjithashtu, mbështetur në nenin 7 të ligjit nr. 13/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8734 datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të paisjeve dhe instalimeve elektrike”, ku citohet se:

“...Përdorimi i pajisjeve elektrike bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, të lëshuar nga një organ i akredituar certifikues personeli për fushën përkatëse...”

Objekti i kësaj kontrate përfshin instalimin fizik, lidhjen, konfigurimin dhe testimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike, duke përfshirë njësinë qendrore të sistemit të diskutimit, monitorët, kamerat PTZ, njësinë e regjistrimit, amplifikatorët, DSP, mikserin audio, altoparlantët, njësinë e sekuencimit të fuqisë, si dhe kabllimet dhe lidhjet përkatëse me infrastrukturën ekzistuese të godinës.

Gjatë realizimit të kontratës do të kryhen ndërhyrje në instalimet elektrike dhe në sistemet me tension të ulët, lidhje të pajisjeve aktive, furnizime elektrike, testime funksionale dhe verifikime të parametrave teknikë, të cilat, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të realizohen nga personel i kualifikuar dhe i autorizuar.

Prania e një punonjësi të pajisur me kartelë të sigurimit teknik garanton që këto ndërhyrje do të kryhen nga personel që disponon njohuritë dhe autorizimet ligjore për të punuar me pajisje dhe instalime elektrike, duke reduktuar rrezikun e aksidenteve në punë, dëmtimit të pajisjeve, defekteve gjatë instalimit dhe ndërprerjes së funksionimit të sistemit.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Standardin ISO 9001 (ose ekuivalente), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Standardin ISO 27001 (ose ekuivalente), për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c) Standardin ISO 45001 (ose ekuivalente), për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes).

Argumentimi: Kërkesat për certifikim sipas standardeve ISO bazohet në përcaktimet e pikës 4 të Nenit 77-Kërkesat për Kualifikim, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), konkretisht:

“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme

njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

si dhe nenin 44, pika 1 të VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar),

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga ofruesi i shërbimit, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Për sa më sipër, kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar me sukses kontratën.

ISO 27001 është një kuadër standartizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomikë në lidhje me :

- mirëmbajtjen e sistemit ISMS (Information Security Management System) brenda vetë organizatës së operatorit ekonomik.*
- aplikimin e praktikave të sigurisë për menaxhimin e risqeve të sigurisë.*
- aplikimin e praktikave të sigurisë për trajtimin e të dhënave sensitive.*
- aplikimin e masave dhe praktikave të sigurisë për shërbimet e kryera në ambiente sensitive.*

Objekti i kësaj kontrate përfshin implementimin e një sistemi multifunksional të integruar, i cili përbëhet nga sistemi i diskutimit dhe votimit elektronik, softueri i administrimit dhe votimit, sistemi i regjistrimit audio-video, kamerat PTZ, si dhe komponentë të tjerë të cilët komunikojnë nëpërmjet rrjetit dhe administrohen përmes platformave software. Operatori ekonomik do të kryejë instalimin, konfigurimin, integrimin, testimin dhe mirëmbajtjen e këtyre sistemeve gjatë gjithë periudhës kontraktore.

Gjatë realizimit të kontratës, operatori ekonomik do të ketë akses në konfigurimet e sistemit, parametrat e komunikimit, regjistrimet audio-video, konfigurimet e softuerit të administrimit dhe votimit, si dhe dokumentacionin teknik të sistemit. Gjithashtu, gjatë periudhës së mirëmbajtjes do të kryejë përditësime software, instalim të patch-eve të sigurisë dhe ndërhyrje teknike në rast incidentesh.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktor kërkon që operatori ekonomik të jetë i çertifikuar me standardin ISO 27001 (ose ekuivalente), i cili garanton:

- identifikimin dhe menaxhimin sistematik të risqeve të sigurisë së informacionit;*

- menaxhimin e aksesit në informacion dhe infrastrukturë;
- mbrojtjen e konfigurimeve, dokumentacionit teknik dhe të dhënave të krijuara ose të administruara gjatë implementimit dhe mirëmbajtjes;
- menaxhimin e incidenteve të sigurisë dhe sigurimin e vazhdimësisë së shërbimit.

ISO 45001 ofron një kuadër të njohur ndërkombëtarisht për menaxhimin e rreziqeve që lidhen me shëndetin dhe sigurinë në punë. Ai u mundëson organizatave të identifikojnë në mënyrë sistematike rreziqet dhe të zbatojnë masa kontrolli, duke reduktuar aksidentet, dëmtimet dhe incidentet në vendin e punës.

Kërkesa për certifikimin ISO 45001 (ose ekuivalente), për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë ose ekuivalente lidhet drejtpërdrejt me natyrën e kontratës, e cila përfshin jo vetëm furnizimin e pajisjeve, por edhe instalimin fizik, konfigurimin, testimin dhe vënien në punë të sistemit multifunksional në ambientet e Sallës së Këshillit Bashkiak.

ISO 45001 është standardi ndërkombëtar për **Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë**, i cili përcakton kërkesat për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin e rreziqeve që lidhen me aktivitetet e punës, me qëllim parandalimin e aksidenteve, dëmtimeve dhe incidenteve profesionale, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së organizatës në fushën e shëndetit dhe sigurisë në punë.

Gjatë realizimit të kontratës, operatori ekonomik do të kryejë aktivitete teknike të tilla si instalimi i kabllimeve të komunikimit dhe energjisë, montimi i kamerave PTZ, monitorëve, altoparlantëve, pajisjeve audio-video, si dhe ndërhyrje në infrastrukturën ekzistuese teknologjike të institucionit. Këto aktivitete paraqesin rreziqe të lidhura me sigurinë dhe shëndetin në punë, përdorimin e mjeteve të instalimit, punën në lartësi për vendosjen e pajisjeve dhe ekspozimin ndaj rreziqeve të ndryshme gjatë procesit të implementimit.

Për këtë arsye, certifikimi ISO 45001 (ose ekuivalente) kërkohet me qëllim garantimin që operatori ekonomik disponon procedura të dokumentuara për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve në punë, si dhe siguron mbrojtjen e personelit të angazhuar në realizimin e kontratës dhe të personelit të Autoritetit Kontraktor gjatë kryerjes së punimeve.

2.3.6. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi ose Distributori të Autorizuar për rajonin e Shqipërisë për zgjidhjen multifunksionale, objekt kontrate.

Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/ email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë autorizimin sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë, objekt kontrate.

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose Distributorit të Autorizuar është vendosur në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 (i ndryshuar), pasi lidhet drejtpërdrejt me aftësinë profesionale dhe teknike të operatorit ekonomik për të furnizuar, instaluar, konfiguruar dhe mirëmbajtur pajisjet objekt kontrate.

Objekti i kontratës përfshin furnizimin dhe implementimin e një zgjidhjeje multifunksionale të integruar, e cila përbëhet nga sistemi i diskutimit dhe votimit elektronik, njësia qendrore, njësitë delegate/chairman, software administrimi dhe votimi, kamerat PTZ, njësia e regjistrimit dhe komponentët e tjerë të integruar të sistemit. Këta komponentë duhet të funksionojnë si një sistem unik dhe plotësisht i integruar.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantojë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë originalitetin e mallrave të furnizuara, si dhe përfshirjen e vet shërbimeve dhe suportit të prodhuesit në projekt, përmes vet atij apo distributorit të autorizuar.

Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar garanton se operatori ekonomik është i autorizuar të furnizojë produktet origjinale, disponon mbështetjen teknike të prodhuesit, ka akses në dokumentacionin teknik, përditësimet software dhe firmware, si dhe mund të sigurojë pjesë këmbimi, garanci dhe suport teknik gjatë gjithë periudhës së implementimit dhe mirëmbajtjes së kontratës.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Qëllimi i kësaj kontrate është ngritja e një infrastrukture me parametra bashkëkohorë të sallës së Këshillit Bashkiak në Bashkinë Tiranë e cila përfshin (por nuk kufizohet) furnizimin, instalimin, konfigurimin dhe vënia në punë e një sistemi të plotë i cili përfshin sistem diskutimi, identifikim elektronik, votim, sistem audio, regjistrim audio-video, kamera PTZ dhe pajisje mbështetëse, në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare dhe kërkesat e institucionit.

Rezultatet që Duhet të Arrihen nga Kontraktori

Furnizim dhe konfigurim për Sistemin e diskutimit (njësi delegate/chairman dhe procesor/njësinë qendrore) sipas kërkesave të këtij dokumenti

Konfigurim të Lexues/Shkrues kartash, monitor

Furnizim dhe konfigurim të kartave elektronike të identifikimit

Furnizim dhe konfigurim Softuer administrimi dhe votimi

Furnizim dhe konfigurim të Kamera PTZ dhe sistem auto-tracking

Furnizim dhe konfigurim për Njësi regjistrimi

Sistem audio i sallës (altoparlantë, amplifikatorë, DSP, mikser)

Operatori ekonomik duhet të sigurojë dhe instalojë të gjithë kabllimin e nevojshëm për funksionimin e sistemit.

Operatori ekonomik duhet të ofrojë një zgjidhje të integruar, ku të gjithë komponentët e sistemit (sistemi i diskutimit, sistemi audio, kamerat PTZ, regjistrimi dhe softueri i menaxhimit) të funksionojnë në mënyrë të koordinuar dhe të jenë plotësisht të integrueshëm ndërmjet tyre.

Operatori ekonomik, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë duhet të mundësojë trajnimin e punonjësve (stafin teknik) në lidhje me përdorimin e sistemit dhe komponentëve objekt kontrate.

Mirëmbajtje të pajisjeve/sistemeve për një periudhë 12 (dymbëdhjetë) muaj duke filluar nga data e marrjes në dorëzim.

Sa më sipër, specifikimet teknike, për shërbimin objekt kontrate "Sistemi Multifunksional për sallën e Këshillit Bashkiak" të cilat përfshihen në Dokumentin e Specifikimeve Teknike dhe termave të referencës, pjesë e DST janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP (i ndryshuar), si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"(i ndryshuar).

Shënim: 1. OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku parashikohet se, "Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla", si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin."

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s'kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s'kualifikimi.

2. Referuar nenit 82, pika 4 e ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 për "Prokurimin publik" , I ndryshuar, "Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë", si dhe Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, "Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur

3. "Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim."

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

*Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave për procedurën e këtij objekti, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 1, 2 dhe 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Argumentimi, sipas materialit të përgatitur nga struktura e posaçme:

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “d”, dhe nenit 64, shkronja “a” të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar); Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për “Menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar); nenit 36 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); nenit 76 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar); V.K.B-së Nr. 131 dt 18.12.2024 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2025”; grupi i punës hartoi specifikimet teknike për realizimin e objektit, duke përcaktuar qartë kërkesat e Autoritetit Kontraktor. Grupi i punës i përbërë nga specialistë të fushës, i ngritur urdhër të Titullarit të AK Bashkia Tiranë, në zbatim të detyrave të përcaktuara në këtë urdhër, pas identifikimit të nevojave, përgatiti specifikimet teknike dhe relacionin prezantues për realizimin e investimit.

Specifikimi i parametrave teknik etj:

Termat e referencës dhe kërkesat funksionale/ specifikimet teknike hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(I ndryshuar).

Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar te njësisë së prokurimit.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt ”Sistemi Multifunksional për sallën e Këshillit Bashkiak”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.